



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Ballsh, më ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit:

“Mirëmbajtje e mjeteve të transportit viti 2024 (për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe NSHP)”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

50112200-5

Vlera e fondit limit:

8,318,684 (tetëmilion e treqind e tetembedhjetemijë e gjashtëqind e tetedhjetë e kater) **lekë pa TVSH nga te cilat :**

- 1,654,100 (njëmilion e gjashtëqind e pesedhjetë e katermijë e njeqind) lekë pa TVSH për nevojat e Autoritetit Kontraktor Bashkia Mallakastër, dhe
- 6,664,584 (gjashtëmilion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e katermijë e peseqind e tetëdhjetë e kater) lekë pa TVSH për nevojat e Autoritetit Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Bazuar në nenin 53, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 67, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër, në rolin e Organit Qendror Blerës (OQB), për nevojat e saj dhe të AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër, ndërsa nënshkrimi i kontratave do të bëhet respektivisht nga secili prej Autoriteteve Kontraktore sipas pjesës takuese.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhërin përkatës të prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesës (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor (OQB) Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82, të LPP dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të

ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njërive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njëria/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3. Kapaciteti teknik :

Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme të suksesshme, kërkohen dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së

njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat si vijon:

- a. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe shërbimet e realizuara, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 41, pika 3 dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- 2.3.2.** Per te operuar me efikasitet lidhur me zbatimin e kontrates objekt prokurimi operatori ekonomik ofertues duhet të ketë te pakten nje ambient/pikë servisi , ne pronesi ose me kontrate qeraje ose me kontrate bashkepunimi.

Per kete operatori ekonomik duhet te paraqesi certifikaten e pronesise ose kontraten e qerase te noterizuar ose kontraten e bashkepunimit te noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i

vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor për ushtrimin e aktivitetit të ofertuesve në ambiente të pershtatshme dhe stabile për ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Dokumentacioni i kërkuar si certifikata e pronesise ose kontrata e qerases e noterizuar ose kontrata e bashkepunimit e noterizuar janë vendosur për arsye që Autoriteti Kontraktor të garantohet se operatori ekonomikë zotëron një ambient/pike servisi të nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi duhet të ketë në përberje të tij personelin e nevojshëm si më poshtë :

- Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, të paktën:
 - 1 (një) Inxhinier mekanik
 - 1 (një) motorrist
 - 1 (një) pompist
 - 1 (një) mekanik

Operatori ekonomik për punonjesin me detyrë Inxhinier Mekanik duhet të paraqesi diplome dhe kontraten e punës. Ndërsa për punonjesit e tjere duhet të paraqesi deshmi aftësie dhe kontrate pune. Operatori ekonomik për të gjithë punonjesit duhet të paraqesi listpagesën e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislati në fuqi për të paktën muajin e fundit të deklaratimit.

*Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur me plotësimin e **Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit**. Ndërsa dokumentacioni provues , do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri është kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë një Inxhinier Mekanik për kryerjen e shërbimeve i cili ka një rol të rëndësishëm në kryerjen e shërbimeve pasi është përgjegjës për zbatimin e objektit të kontratës në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Dokumentacioni plotësues i kërkuar si : kontratë pune, diploma , liste pagesa etj janë vendosur për arsye që Autoriteti kontraktor të garantohet se drejtuesi teknik dhe punonjesit e tjere janë pranishëm pranë operatorit ekonomik gjatë zbatimit të kontratës dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se operatori ekonomikë zotëron personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Duke ju referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime e mirmbajtje të motorreve, pompave, te sistemeve drejtimit, etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, pompist, mekanik e vertetuar kjo me ane te kontratave te kontratave te punës., Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit ,bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim qe merr persiper transportin e mjeteve te difektuara nga ambientet e Bashkise Mallakaster dhe Ndermarrjes se Sherbimeve Publike deri ne piken e servisit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim, nëpërmjet të cilës të deklarojë me përgjegjësi se ka të gjitha mjetet, aparaturat dhe aksesoret e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përgatitur nga struktura përkatëse duke iu referuar nenit 36 të të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Hartimi i specifikimeve teknike është kryer duke iu referuar kërkesave dhe nevojave për shërbime që kanë mjetet e Ndermarrjes së Shërbimeve Publike dhe Bashkisë Mallakastër.

Specifikimet teknike për shërbimet e kërkuara përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 41).

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden bashkëngjitur DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Afati i Ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e lidhjes se kontrates.

NJËSIA E PROKURIMIT